



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 423/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Fejzullah Rexhepi, Kryesues, Adnan Konushevi dhe Faton Ademi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares së lartë ligjore Antigona Murati, duke vendosur përkitazi me ankesën e parashtruar nga Haki Demolli kandidat për deputet në Kuvendin e Republikës së Kosovës, nga radhët e koalicionit LDK-AKR me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Vendimit për shpalljen e rezultatit përfundimtar të publikuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) me datë 29.06.2017, për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare, në seancën e panelit të mbajtur me 01.07.2017, mori këtë:

## V E N D I M

**REFUZOHET** si e pabazuar ankesa e parashtruar nga Haki Demolli kandidat për deputet në Kuvendin e Republikës së Kosovës, nga radhët e koalicionit LDK-AKR me seli në Prishtinë

## A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datën 30.06.2017 në ora 14:20 nga Haki Demolli kandidat për deputet në Kuvendin e Republikës së Kosovës, nga radhët e koalicionit LDK-AKR me seli në Prishtinë, në të cilën ankesë është pretenduar se nga publikimi i rezultateve përfundimtare - zyrtare të shpallura nga Komisioni Qendror Zgjedhor KQZ, konsideroi se me datë 29.06.2017 në komunat e Vitisë, Pejës, Obiliqit, Klinës dhe Istogut ka pasur mos përputhje të rezultateve, në mes të rezultateve preliminare dhe përfundimtare, bazuar në Formularët e Rezultateve për Kandidatët FRK .

Parashtruesi i ankesës në ankesën e parashtruar kërkon që të hetoi dhe verifikoi Formularët e Rezultateve për Kandidatët FRK, në komunat e lartpërmendura .

PZAP-i, pas shqyrtimit të besueshmërisë së ankesës dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore, si dhe shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

### **ankesa është e pabazuar**

PZAP-i, konstatoi se pretendimet ankimore janë të pabazuara ngase parashtruesi i ankesës me ankesën e tij kërkon që të hetohen dhe verifikohen Formularët e Rezultateve për Kandidatët FRK në komunat e Vitisë, Pejës, Obiliqit, Klinës dhe Istogut, pasi që bëhet fjalë

për mos përputhje të rezultateve të shpallura nga KQZ-ja, respektivisht në mes të rezultateve preliminare përfundimtare .

Mirëpo nga pretendimet ankimore me asnjë provë bindëse nuk është dëshmuar se në cilin vendvotim VV në komunat e përkatëse – të lartëcekura iu janë bërë parregullsi, ashtu siç pretendon, prandaj lidhur me këtë çështje PZAP-i ankesën e parashtruesit e konsideron si të përgjithshme dhe të pa bazuar konform dispozitës ligjore të nenit 117 i Ligjit nr. 03/-073 për Zgjedhjet e Përgjithme në Republikën e Kosovës.

Prandaj, PZAP-i, konstatoi se pretendimet ankimore janë të pabazuara ngase parashtruesi i ankesës nga dëshmia e ofruar nuk ka mundur për ti vërtetoj pretendimet ankimore edhe pse barra e te provuarit bie mbi parashtruesin e ankesës, po ashtu nuk ka dhënë asnjë udhëzim apo hollësi se ku mund të gjenden dëshmitë, të cilat nuk i ka pasur në posedim lidhur me atë çka pretendon në ankesë.

Rrjedhimisht PZAP-i në mungesë të provave dhe dëshmive konkrete dhe bindëse për pretendimet e paraqitura në ankesë, konstaton se ankesa në fjalë është e pabazuar dhe e pa argumentuar dhe si të tillë ankesën e ankuesit e refuzoj.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

Anr.423/2017 më datën 01.07.2017.



**Kryesuesi i Panelit  
Fejzullah Rexhepi**

***Udhëzim Juridike:***

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelime, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.